



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 117

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 8 korrik 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 244, datë 5.7.2024	Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Himarë, qarku Vlorë..... 14155
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 444, datë 3.7.2024	Për shtimin e kategorive tematike të grupeve të të dhënave me vlerë të madhe..... 14155
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 445, datë 3.7.2024	Për një ndryshim në vendimin nr. 270, datë 2.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS)”, të ndryshuar..... 14158
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 446, datë 3.7.2024	Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar..... 14158
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 447, datë 3.7.2024	Për miratimin e raportit vjetor për ndihmat shtetërore të vitit 2023..... 14287
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 448, datë 3.7.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar, dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e të studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar..... 14297
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 449, datë 3.7.2024	Për rregullat e detajuara për regjistrimin e kimikateve nga prodhuesit dhe importuesit, detyrimet për të raportuar në Regjistrin Elektronik të Kimikateve, si dhe mirëmbajtjen e regjistrit të kimikateve..... 14298
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 489, datë 27.6.2024	Për delegim të përkohshëm kompetencash..... 14301



DEKRET
Nr. 244, datë 5.7.2024

PËR CAKTIMIN E DATËS SË
ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR TË
BASHKISË HIMARË, QARKU VLORË

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “g”, dhe nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Caktimin e datës 4 gusht 2024 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Himarë, qarku Vlorë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 444, datë 3.7.2024

PËR SHTIMIN E KATEGORIVE
TEMATIKE TË GRUPEVE TË TË
DHËNAVE ME VLERË TË MADHE¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 16, të ligjit nr. 33/2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qëllimi i këtij vendimi është:

a) shtimi i të dhënave me vlerë të madhe të lëvizshmërisë;

b) përcaktimi i grupeve specifike të të dhënave me vlerë të madhe të lëvizshmërisë dhe të transportit publik;

c) përcaktimi i masave për publikimin e ripërdorimin, kushtet e zbatueshme për ripërdorim dhe kërkesat minimale për shpërndarjen e të dhënave nëpërmjet ndërfaqeve të përdorimit të aplikimit (në vijim “API”).

2. Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e dhëna në nenin 6, të ligjit nr. 33/2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.

3. Grupet e të dhënave me vlerë të madhe, të lëvizshmërisë dhe të transportit publik përfshijnë:

a) të dhënat e rrjeteve të transportit publik: rrugor, hekurudhor, ajror, ujor dhe infrastrukturat e lidhura me to, përfshirë ato të përcaktuara si pjesë e rrjeteve të transportit transevropian, *Ten-T*;

b) të dhënat statike të rrugëve ujore të brendshme;

c) të dhënat dinamike të rrugëve ujore të brendshme.

4. Të dhënat specifike për të dhënat e rrjeteve të transportit, sipas shkronjës “a”, të pikës 3, të këtij vendimi, janë të dhënat e përcaktuara me standardin e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të ligjit për të dhënat gjeohapësinore për grupet tematike për rrjetet e transportit.

5. Të dhënat specifike statike për rrugët e brendshme ujore sipas shkronjës “b”, të pikës 3, të këtij vendimi, janë:

a) karakteristikat e rrugës së lirë (*fairway*);

b) pengesat afatgjata në rrugë dhe besueshmëria;

c) pagesat e tarifave të infrastrukturës së rrugëve ujore;

ç) kufizime të tjera fizike në rrugët ujore;

d) koha e rregullt e funksionimit të bllokimit dhe të urës;

dh) vendndodhja e karakteristikat e porteve dhe të vendeve të transportit;

e) lista e mjeteve ndihmëse të lundrimit dhe të shenjave të trafikut;

ë) rregullat e rekomandimet e lundrimit.

6. Të dhënat specifike dinamike për rrugët e brendshme ujore, sipas shkronjës “c”, të pikës 3, të këtij vendimi, janë, si më poshtë vijon:

¹ Ky vendim është përafuar pjesërisht me rregulloren zbatuese të Komisionit Evropian 2023/138/BE, të datës 21 dhjetor 2022, që përcakton një listë të grupeve specifike të

të dhënave me vlerë të madhe dhe masat për publikimin dhe ripërdorimin e tyre, numër Celex 32023R0138, Fletore Zyrtare nr. 19, datë 20.1.2023, f. 43–75.



- a) konturet e thellësive të ujit në kanalën e lundrimit;
- b) pengesat e përkohshme në rrugë të lirë;
- c) nivelet e tanishme dhe të ardhshme të ujit në matës;
- ç) gjendja e lumenjve, e kanaleve dhe e urave;
- d) kufizimet e shkaktuara nga përmytjet dhe akulli;
- dh) ndryshimet afatshkurtra të kohës së funksionimit e të bllokimit të urës;
- e) ndryshimet afatshkurtra të mjeteve ndihmëse në lundrim;
- ë) hartat elektronike dhe naviguese të brendshme, sipas standardit ECDIS;
- f) aksi i rrugës ujore me tregues kilometrash;
- g) lidhja me skedarët “xml” të jashtëm me kohë funksionimi të strukturave kufizuese;
- gj) vendndodhja e porteve dhe e vendeve të transportit;
- h) të dhënat e referencës për matësit e nivelit të ujit, që lidhen me lundrimin;
- i) bregu ujqor në nivelin mesatar të ujit;
- j) vijat bregdetare;
- k) konturet e digave;
- l) kufijtë e rrugës së lirë/kanalit të lundrimit;
- ll) rreziqet e izoluara në rrugën e lirë/kanalin e lundrimit nën dhe mbi ujë;
- m) ndihma zyrtare për lundrim (p.sh. bova, fener, drita, shenja njoftimi).

7. Publikimi i të dhënave me vlerë të madhe të lëvizshmërisë bëhet, si më poshtë vijon:

a) Organet e sektorit publik dhe privat, kur kryejnë funksione publike, që mbajnë grupe të dhënash me vlerë të madhe, të listuara në pikën 3, të këtij vendimi, sigurojnë që grupet e të dhënave të përshkruara ose të referuara në të, kur janë të ruajtura në një bazë të të dhënave shtetërore, të vihen në dispozicion në format të lexueshëm nga pajisje kompjuterike nëpërmjet API-ve, që plotësojnë nevojat e ardhshme për ripërdorim;

b) Grupet e të dhënave me vlerë të madhe të lëvizshmërisë vihen në dispozicion dhe në formën e një shkarkimi të vetëm voluminoz (*bulk download*), kur të dhënat nuk ruhen në baza të të dhënave shtetërore;

c) Organet e sektorit publik të përmendura në shkronjën “a”, të kësaj pike, përcaktojnë dhe publikojnë kushtet e përdorimit të API-së dhe kriteret e cilësisë së shërbimit për performancën, kapacitetin dhe disponueshmërinë e tij;

ç) Kushtet e përdorimit të jenë të disponueshme në një format të lexueshëm nga njeriu dhe nga kompjuteri, që, bashkë me kriteret e cilësisë së shërbimit, të jenë në përputhje me marrëveshjet për ripërdorimin e grupeve të të dhënave me vlerë të lartë, në përputhje me pikën 3, të këtij vendimi;

d) Kushtet e përdorimit të API-së shoqërohen me dokumentacionin e duhur në një format të hapur, të lexueshëm nga njeriu dhe kompjuteri, sipas standardeve të njohura;

dh) Organet e sektorit publik të përmendura në shkronjën “a”, të kësaj pike, caktojnë një pikë kontakti për çështjet që lidhen me API-në, për të siguruar disponueshmërinë dhe mirëmbajtjen e API-së dhe publikimin efektiv të grupeve të të dhënave me vlerë të madhe;

e) Organet e sektorit publik e privat, kur kryejnë funksione publike, që mbajnë grupe të dhënash me vlerë të madhe sipas këtij vendimi, sigurojnë që grupet e të dhënave të klasifikohen si grupe të dhënash me vlerë të madhe, në përshkrimin e tyre të metadatave.

8. Ripërdorimi i kategorisë së grupeve të të dhënave me vlerë të madhe të lëvizshmërisë dhe transportit publik bëhet, si më poshtë vijon:

a) çdo përjashtim, në përputhje me pikën 4, të nenit 17, të ligjit nr. 33/2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, publikohet *online* në faqen e internetit të institucionit përkatës dhe, për aq sa është e mundur, në portalin unik qeveritar të të dhënave të hapura, në përputhje me parashikimet e pikës 3, të nenit 10, të ligjit nr. 33/2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”;

b) për të lehtësuar disponueshmërinë e grupeve të të dhënave për ripërdorim, që mbulojnë periudha më të gjata kohore, detyrimet e vendosura sipas këtij dokumenti do të zbatohen, gjithashtu, për grupet ekzistuese të të dhënave me vlerë të madhe të lexueshme nga kompjuteri, të krijuara përpara datës së zbatimit të këtij vendimi;

c) grupet e të dhënave me vlerë të madhe për lëvizshmërinë vihen në dispozicion për ripërdorim sipas kushteve të licencës përkatëse për të drejtën e ripërdorimit të miratuar në zbatim të ligjit nr. 33/2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”. Organi publik licencues për ripërdorimin e të dhënave me vlerë të madhe për lëvizshmërinë ka të drejtën e atribuimit për vendosjen e një karakteristike të objektit ose të



një grupi të dhënash të entitetit, të tilla si një emër ose kod kombëtar identifikimi;

ç) grupet e të dhënave me vlerë të madhe për lëvizshmërinë, siç përcaktohet në pikën 6, të këtij vendimi, vihen në dispozicion, në përputhje me rregullat për publikimin e ripërdorimit, sipas ligjit nr. 33/2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.

9. Publikimi i grupit të të dhënave për rrjetet e transportit dhe bërja e disponueshme e tyre për ripërdorim bëhet, si më poshtë vijon:

a) menjëherë pas përditësimit të fundit;

b) sipas kushteve të licencës “Creative Commons BY 4.0” ose ndonjë licence të hapur ekuivalente ose më pak kufizuese;

c) në një format të hapur, të lexueshëm nga kompjuteri, të njohur ndërkombëtarisht;

ç) përmes API-ve dhe në formën e një shkarkimi të vetëm voluminoz “bulk download”;

d) në versionin e tyre më të përditësuar.

9.1. Metadat, që përshkruajnë grupet e të dhënave të rrjetit të transportit, duhet të përmbajnë të paktën elementet e metadatave të përcaktuara, sipas legjislacionit në fuqi për të dhënat e hapura:

a) datasetet do të përshkruhen në një dokumentacion të plotë dhe të disponueshëm në internet, i cili përshkruan të paktën strukturën dhe semantikën e të dhënave;

b) grupet e të dhënave përdorin fjalorin dhe taksonominë sipas praktikës evropiane ose standardeve të njohura ndërkombëtarisht e të dokumentuara publikisht, aty ku ka.

10. Publikimi i grupit të të dhënave për rrugët ujore të brendshme dhe bërja e disponueshme e tyre për ripërdorim bëhet, si më poshtë vijon:

a) sipas kushteve të licencës “Creative Commons BY 4.0” ose ndonjë licence të hapur ekuivalente ose më pak kufizuese;

b) në formatin e përcaktuar sipas praktikës së harmonizuar me Bashkimin Evropian:

i. nëpërmjet API-së dhe në formën e një shkarkimi të vetëm voluminoz “bulk download”;

ii. duke përfshirë atributin e kodit të vendndodhjes së Standardit Ndërkombëtar të Raportimit të Anijeve (“ISRS”);

iii. në përputhje me frekuencën e përditësimit dhe afatin kohor të specifikuar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi;

iv. në zbërthimin e detajuar, sipas përcaktimeve në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10.1. Metadat, që përshkruajnë grupet e të dhënave të rrugëve ujore të brendshme, duhet të jenë të plota dhe të disponueshme në *web* të organit të sektorit publik dhe në portalin unik qeveritar të të dhënave të hapura, në një format të hapur, të lexueshëm nga kompjuteri, të njohur ndërkombëtarisht ose në Bashkimin Evropian;

10.2. Dokumentacioni i grupeve të të dhënave të rrugëve ujore të brendshme, duhet të jetë në përputhje me masat dhe standardet e harmonizuara me Bashkimin Evropian.

11. Organet e sektorit publik, që mbajnë të dhënat sipas përcaktimeve të këtij vendimi, paraqesin informacionin e nevojshëm te Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Aty ku është e përshtatshme, informacioni mund të sigurohet nëpërmjet referencave në metadatat përkatëse.

12. Organet publike përgjegjëse për mbajtjen e grupeve të të dhënave me vlerë të madhe sipas këtij vendimi marrin masa për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Grupi i të dhënave	Statike	Dinamike/urgjente	Hartat elektronike të navigimit
Frekuenca dhe kohëzgjatja e përditësimit	Kur është e nevojshme	Çdo ditë në (afër) kohë reale	Çdo tre muaj, në rast të ndryshimeve në dataset
Zbërthimi i detajuar	Niveli individual i një kilometri ose miljeje detare të rrugës ujore; niveli i hektometrit të rrugës ujore aty ku është e aplikueshme		Rrjeti Kombëtar i Rrugëve Ujore dhe Nyja Ndërkufitare